



www.legjislacioni.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 19

Tiranë – E hënë, 14 dhjetor 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 7975, datë 22.10.2015	3
Hapja e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Vaporusa-Alb” sh.p.k., me NIPT K51625022G, bazuar në nenet 11, 13, 15, 19(3), 30(1)(b) e vijues, të ligjit nr. 8901/2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar, dhe Kodin e Procedurës Civile.....	3



VENDIM

Nr. 7975, datë 22.10.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me trup gjykues të përbërë nga:

Rezarta Mataj, gjyqtare.

Me sekretare gjyqësore Megi Anxhela Muhaj, në Tiranë, sot në datën 22 tetor 2015, ora 09:30, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen civile tregtare që i përket:

KËRKUES: Shoqëria “Valsir” spa, shoqëri e së drejtës italiane në Vestone, BS, lokaliteti Merlaro, nr. 2, Itali, me numër 02878210174, IVA 00700170988, e përfaqësuar me prokurë të posaçme nga av. Ervin Bano dhe Sajmir Dautaj, anëtarë të Dhomës së Avokatisë, Tiranë, me adresë zyre: rruga “Abdi Toptani”, Torre Drin, kati II, Tiranë.

PERSON I TRETË:

1. Shoqëria “Vaporusa-Alb” sh.p.k., me administrator.

2. Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë (në mungesë).

3. Banka “Veneto” sh.a. (në mungesë).

OBJEKTI: Hapja e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Vaporusa-Alb” sh.p.k., me NIPT K51625022G, bazuar në nenet 11, 13, 15, 19(3), 30(1)(b) e vijues, të ligjit nr. 8901/2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar, dhe Kodin e Procedurës Civile.

- Në bisedimet përfundimtare, përfaqësuesi i kërkuesit pretendoi “*Pramimin e kërkesës si të mbështetur në ligj dhe në prova*”, ndërsa personat e tretë në mungesë gjatë gjithë gjykimit.

- Gjykata, pasi zhvilloi hetimin gjyqësor, konsultoi çështjen në tërësi në ligj material, procedural, prova dhe formoi bindjen e saj të brendshme,

VËREN SE:

1. Shoqëria italiane “Vaporusa” spa i drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (më tej, GJRRGJ Tiranë) me objekt e bazë ligjore si në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

2. GJRRGJ Tiranë, seksioni tregtar i saj, ka kompetencë lëndore dhe tokësore si gjykata në rrethin gjyqësor të të cilit ndodhet selia e shoqërisë debitore që kërkon të deklarohet falimentimi, konkretisht në Tiranë, sipas nenit 4, të ligjit nr. 8901/2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar.

3. Në gjykim, gjykata kryesisht sipas nenit 193 të KPRC-së dhe nenit 17§2 të ligjit nr. 8901/2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar, edhe debitorin shoqëria “Vaporusa-Alb” sh.p.k., me seli në Tiranë. Po ashtu, pasi u lexua raporti i administratores së përkohshme të falimentimit, u konstatua se persona të tjerë kreditorë, karshi “Vaporusa-Alb” sh.p.k., është edhe Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë dhe “Veneto Bank” sh.a. (shih shumat konkrete të raportit i administratores së falimentimit, datë 15 korrik 2015).

II. Mbi rrethanat dhe faktet e çështjes.

3. Sipas ekstraktit të thjeshtë të QKR-së, shoqëria “Vaporusa-Alb” sh.a., datë 29 prill 2015, si dhe ajo historiku të printuar nga gjykata, pasi u bë këqyrja *online* në faqen elektronike qkr.gov.al, bazuar te neni 286 të KPRC-së, kjo shoqëri mbart këto të dhëna: e regjistruar në datën 11 shkurt 2015, me NUIS K51625022G, Tiranë, Kashar, KASHAR, autostrada Tiranë-Durrës, rruga dytësore, km 5, me objekt të veprimtarisë: “*Tregtimi me shumicë dhe pakicë, import-eksporti dhe distribucioni i materialeve dhe i pajisjeve për impiante teknologjike, mekanike, kondicionimi, ventilimi, ngrohje, hidrosanitare dhe mbrojtjes nga zjarri, impiante të trajtimit dhe pastrimit të ujit, pishina, ujësjellësa, impiante të ujërave të zeza, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi dhe ujëtjeje, procese industriale, impiante rregullimi dhe kontrolli. Transporti i mallrave me mjetet e veta për llogari të shoqërisë apo të të tretëve*”.

4. Me vendimin e datës 3104, datë 5 mars 2014, të GJRRGJ Tiranë, vendoset: “*Detyrimi i të paditurit, shoqëria “Vaporusa-Alb” sh.p.k., t’i paguajë paditësit shoqërisë “Valsir” spa shumën prej 44 163 52 eurosh, si dhe dëmin e shkaktuar për shkak të vonësës në likuidim nga data e lindjes së detyrimit deri në datën e kryerjes së aktit, datë 13 shkurt 2014, në shumën prej 1210 eurosh*”.

5. Për këtë titull ekzekutiv kanë filluar veprimet përmbartimore dhe sipas shkresës së datës 27 shkurt 2015, nr. 880 prot., përmbartuesi privat Ermir Godaj, se nuk është i mundur ekzekutimi i këtij titulli, pasi pala debitore nga verifikimet e bëra nuk ka asnjë pasuri të paluajtshme në ZVRPP Tiranë, ka një sekuestro konservative ndaj kapitalit të kësaj shoqërie, me kreditor bankën “Veneto Bank” sh.a., ka llogari bankare, por ato janë negative, nuk ka asnjë automjet të regjistruar.

6. Sipas përgjigjes së datës 15 korrik 2015, me nr. 47987/1 prot., të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, ndaj këtij institucioni ka 17 448 5111 lekë



në TVSH; 50664 lekë, sigurime shëndetësore, shoqërore 5 687 lekë dhe për vitin 2014 nuk ka depozituar asnjë pasqyrë financiare apo të ketë deklaruar sigurime shoqërore, shëndetësore etj., nga dhjetor 2014 e deri tani.

7. Ndërsa sipas pasqyrave financiare 2013 ka një detyrim prej 147 464 967 lekësh.

8. Në këto kushte, sipas nenit 13§2 të ligjit për falimentimin, mospagesa e detyrimeve passjell prezumim se debitori është në gjendje të paaftësisë paguese, e për këtë arsye, legjitimon kreditorin të kërkojë hapjen e procedurave të falimentimit.

9. Në gjykim, gjykata caktoi si administratore të përkohshme të falimentimit znj. Anida Nuri, nga ku, sipas pyetjeve të shtruar nga gjykata, iu përgjigj me raportin e datës 15 korrik 2015, në këtë mënyrë: “Shoqëria “Vaporusa-Alb” sh.p.k., që prej datës 31 dhjetor 2013, ka detyrime të mëdha, krahasuar me kapitalin e vet, në raportin 3% kapital dhe 97% detyrime, duke qenë në gjendje të mbingarkesës në borxhe. Aktualisht nuk ka aktivitet tregtar dhe gjendja e saj është përkeqësuar. Shkakun i hapjes së procedurës së falimentimit është real dhe ekziston. Pasuritë e debitorit nuk i mbulojnë shpenzimet e procedurës së falimentimit, të cilat janë 1 000 000 lekë, nuk ka nevojë të merren masa sigurimi për pasurinë e debitorit “Vaporusa-Alb” sh.p.k., si dhe aktualisht kjo shoqëri nuk mund të ushtrojë aktivitetin e saj”.

10. Në gjykim, pasi dëgjoi edhe pretendimin e palës kërkuese, kreditorit, i cili është i gatshëm të parapaguajë shpenzimet e procedurës së falimentimit, gjykata, në përputhje me nenin 19§1 të ligjit për falimentimin, që kreditori të derdhë këtë shumë shpenzimesh në një llogari bankare të hapur nga administratorja e falimentimit. Rezulton se në llogarinë bankare, pranë bankës “Raiffeisen Bank” sh.a., është derdhur shuma prej 7120 eurosh nga “Valsir” spa për administratoren e përkohshme të falimentimit Anida Nuri.

III. Legjislacioni i zbatueshëm

11. Ligji nr. 8901/2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar

Neni 13 - Shkaku i hapjes së procedurës së falimentimit

“1. Procedura e falimentimit hapet vetëm me shkak.

2. Gjendja e paaftësisë paguese përbën shkak të përgjithshëm për hapjen e procedurës së falimentimit. Debitori vlerësohet i paaftë për të paguar nëse nuk është në gjendje të paguajë detyrimet në datën e maturimit. Paaftësia paguese prezumohet se ekziston nëse debitori nuk kryen pagesat.

...

4. Mbingarkesa me borxhe përbën shkak për hapjen e procedurës së falimentimit në rastin e një personi juridik. Debitori ndodhet në gjendjen e mbingarkesës me borxhe kur vërtetohet se pasuritë e tij nuk mbulojnë detyrimet ndaj të tretëve dhe, në bazë të rrethanave, pas vlerësimit të pasurive të debitorit nuk është më mundësia për vazhdimësinë e veprimtarisë.

Procedurat për fallimin e procesit të falimentimit në organin tatimor kryhen sipas legjislacionit tatimor përkatës...”.

Neni 17 - Kërkesa e kreditorit

“1. Kërkesa e kreditorit pranohet nga seksioni tregtar i gjykatës së rrethit, kur ai ka një interes të ligjshëm për hapjen e procedurës së falimentimit, kur paraqet kërkesën sipas ligjit dhe, nëse gjykata çmon se shkaqet për hapjen e procedurës së falimentimit janë të mjaftueshme dhe bindëse për të. Vlerësohen se kanë interes të ligjshëm për hapjen e procedurës së falimentimit, kreditori, i cili ka ndaj pasurisë së debitorit një interes me karakter pasuror dhe autoritetet fiskale. Shkakun për hapjen e procedurës së falimentimit prezumohet se ekziston nëse debitori, pavarësisht se nuk e ka kundërshtuar pretendimin, nuk e ka shlyer këtë detyrim tre muaj pas datës së maturimit të pagesës.

2. Nëse kërkesa e kreditorit pranohet, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit thërret dhe dëgjon pretendimet e debitorit.”

Neni 18

“...

4. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit, brenda afateve të treguara në pikën 3 të këtij neni, vendos:

a) Rrëzimin e kërkesës për mungesë të shkakut ligjor për hapjen e procedurës së falimentimit.

b) Rrëzimin e kërkesës për shkak të pamjaftueshmërisë së pasurive të debitorit për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit.

c) Pranimin e kërkesës dhe hapjen e procedurës së falimentimit.

5. Kundër vendimit të seksionit tregtar të gjykatës së rrethit, për pranimin e kërkesës, dhe hapjen e procedurës së falimentimit ose për rrëzimin e kësaj kërkesë, mund të bëhet ankim i veçantë nga debitori ose kërkuesi për hapjen e procedurës së falimentimit.”

IV. Vlerësimi i gjykatës bazuar në ligj dhe në prova

12. Shkaku – Sipas nenit 13 të ligjit të posaçëm, falimentimi është shkalla më e fundit e pamundësisë së një personi juridik për të vazhduar veprimtarinë e tij e më pas për t’u mbyllur pasi të ketë likuiduar debitorin e tij.

12.1 Falimentimi i një shoqërie, duke qenë



mënyra më e fundit e mbylljes së veprimtarisë së saj, përveç prishjes, likuidimit ajo duhet të hapet gjithmonë me shkak. Shkaqet kryesore të hapjes së procedurës së falimentimit, janë: mbingarkesa në borxhe për shoqëritë tregtare dhe/ose paaftësi për të paguar detyrimet, e cila mund të jetë e afërt ose e largët. E para nënkupton kur vërtetohet se pasuritë e tij nuk mbulojnë detyrimet ndaj të tretëve dhe, në bazë të rrethanave, pas vlerësimit të pasurive të debitorit, nuk është më mundësia për vazhdimësinë e veprimtarisë, ndërsa e dyta nënkupton kur debitori nuk është në gjendje të paguajë detyrimet në datën e maturimit.

13. **Subjektet** – kërkesën për hapjen e procedurës së falimentimit mund ta bëjnë në gjykatë kreditori/ët, debitori ose organet tatimore. Secili prej këtyre subjekteve duhet të përmbushë një sërë kërkesash para gjykatës mbi kushtet e falimentimit.

14. Në rastin konkret, sipas nenit 19 të ligjit të posaçëm, kërkuesi kreditor duhet të provojë para gjykatës, se:

- *Ka shkak një interes të ligjshëm pra, ndaj pasurisë së debitorit një interes me karakter pasuror;*
- *Kërkesën e ka paraqitur konform ligjit;*
- *Shkakun për hapjen e procedurës së falimentimit prezumohet se ekziston nëse debitori, pavarësisht se nuk e ka kundërshtuar pretendimin, nuk e ka shyer këtë detyrim tre muaj pas datës së maturimit të pagesës.*

15. Nga pikëpamja formale janë paraqitur të gjitha dokumentet e kërkuara nga ligji për falimentimin, e cila u provua me dokumentacionin e paraqitur në gjykatë nga ana e kërkuarit.

16. Nga pikëpamja materiale, po ashtu u provua se debitori “Vaporusa-Alb” sh.p.k., ka që më 8 maj 2014, që i detyrohet të paguajë shumën prej 44 163.52 eurosh bashkë me interesat dhe nuk i ka paguar. Bazuar në aktivitetin e shoqërisë, sipas akteve shkresore, por edhe sipas raportit të administratores së falimentimit, shoqëria është pasive, nuk ka asnjë fitim, përveç detyrimeve karshi “Valsir” spa, “Veneto Bank” sh.a., për të cilën është vendosur edhe skuestro konservative ndaj kapitalit të saj, si dhe ndaj Drejtorisë Rajonale Tatimore për mospagesë të TVSH-së, sigurimet shoqërore etj. Aktivitet e shoqërisë nuk mbulonin as shpenzimet e procedurës së falimentimit.

17. Në kushtet kur debitori derdhi në favor të mbulimit të shpenzimeve të procedurës, shumën prej 7120 eurosh në bankë në emër të

administratores së përkohshme, gjykata çmon se sipas nenit 18§c të ligjit, vendos të pranojë kërkesën dhe të deklarojë të hapur procedurën e falimentimit.

18. Me hapjen e kësaj procedure, në orën dhe në datën e shpalljes së këtij vendimi, në datën 22 tetor 2015, gjykata ka për detyrë të njoftojë, publikisht, institucione të parashikuara nga nenet 26-31, të ligjit nr. 8901/2002, me qëllimin që të vihen në dijeni për pezullim të veprimeve të mëtejshme, të bëjnë shënime në regjistrat e tyre për të paralajmëruar personat e tretë që të mos kryejnë veprime me këtë shoqëri, të vendosen bllokime në pasuritë e tyre etj.

19. Sipas nenit 29, të ligjit nr. 8901/2002, me hapjen e procedurave të falimentimit, kreditorët duhet të mbajnë mbledhjen për raportim 45 deri 90 nga e sotme e shpalljes së këtij vendimi, ku administratori duhet të japë raportin e tij për gjendjen e pasurisë së debitorit etj., kreditorët duhet të mblidhen për verifikim të pretendimeve 10–60 ditë nga dita ku përfundojnë depozitimi i pretendimeve. Po ashtu edhe çdo person, i cili ka detyrime të pashlyera ndaj debitorit, duhet të njoftojë administratorin e falimentimit.

20. Bashkë me hapjen e procedurës së falimentimit, gjykata ka për detyrë të caktojë edhe administratorin e falimentimit, e cila jo domosdoshmërisht duhet të jetë administratorja e përkohshme e falimentimit, por për këtë gjykatë, meqenëse eksperte Anida Nuri ka njohur të krijuara për këtë rast, si dhe raporti i kryer prej saj ishte korrekt dhe profesional dhe pa kontestime për palët, gjykata vendosi ta caktojë edhe si administratore të falimentimit. Sipas qëllimit të këtij ligji, marrëdhënia që krijojnë kreditorët, debitori me administratorin e falimentimit, duhet të vishet nga besimi, gjë që shikohet nga gjykata që në fazën e gjykimit të hapjes së procedurës së falimentimit.

21. Në lidhje me afatin e ankimit, sipas nenit 7§3 të ligjit për falimentimin, ndaj këtij vendimi bëhet ankim i veçantë, fillon nga data e shpalljes së vendimit ose, kur vendimi shpallet në mungesë të palëve, nga data kur palët marrin dijeni.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata bazuar në 13§4, 18, 26 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar, dhe nenet 126, 306-310, 102-106 të Kodit të Procedurës Civile,



VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës së kërkesit shoqëria “Valsir” spa, me seli në Vestone, Itali, si e mbështetur në ligj dhe në prova.

2. Të deklarojë të hapur procedurën e falimentimit për shkak të paaftësisë paguese, ndaj debitorit shoqëria “Vaporusa – Alb” sh.p.k. me NUIS K51625022G, me adresë Kashar, autostrada Tiranë-Durrës, rruga dytësore, km 5, me administrator Franco Foresti dhe fushë të veprimtarisë “Tregtim me shumicë dhe pakicë, import-eksporti dhe distribucioni i materialeve dhe pajisjeve për impiante teknologjike, mekanike, kondicionimi, ventilimi etj.”

3. Koha e deklarimit të hapjes së procedurës së falimentimit, është ora 09:55, datë 22 tetor 2015.

4. Emërimin si administratore të licencuar të falimentimit, për shoqërinë “Vaporusa-Alb” sh.p.k., të znj. Anida Nuri, me adresë: rruga “Bab Rexha”, pallati nr. 10/1, ap. 27, Tiranë.

5. Të gjithë kreditorët e shoqërisë “Vaporusa-Alb” sh.p.k., të paraqesin pranë administratores së falimentimit, pretendimet e tyre, brenda 90 ditëve nga dita e shpalljes së këtij vendimi, dhe t’i paraqesin pretendimet dhe të drejtat e tyre të siguruara mbi pasuritë e debitorit.

6. Personat që kanë detyrime ndaj debitorit, shoqërisë “Vaporusa-Alb” sh.p.k. t’ia paguajnë dhe t’ia shlyejnë ato administratores së falimentimit.

7. Mbledhja e kreditorëve për raportim, të mbahet brenda 90 ditëve nga shpallja e këtij vendimi, ndërsa për verifikim të mbahet brenda 60 ditëve nga përfundimi i afatit të depozitimit të pretendimeve.

8. Ky vendim i komunikohet debitorit “Vaporusa-Alb” sh.p.k. dhe kreditorëve të “Veneto Bank” sh.a. dhe Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.

Urdhërohet publikimi i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Vaporusa-Alb” sh.p.k. dhe bërjen e veprimeve përkatëse në regjistra:

- Buletinin e Njoftimeve Publike të Qendrës së Botimeve Zyrtare;

- Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe publikimin e saj në faqen e saj elektronike;

- Dhomës Kombëtare të Noterëve;

- Zyres Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për të njoftuar zyrtare vendore;

- t’u dërgohet të gjitha bankave të nivelit të dytë të Republikës së Shqipërisë;

- Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe publikimin e saj në faqen zyrtare elektronike;

- Autoritetit Krugor Kombëtar pranë Ministrisë së Transporteve;

- Në faqen zyrtare elektronike të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;

- Publikimin e dispozitivit të vendimit në dy gazeta me qarkullim kombëtar, të përcaktuar nga administratorja e falimentimit, dy herë radhazi.

9. Ky vendim është menjëherë i ekzekutueshëm.

10. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen kërkesit.

11. Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë.

12. Brenda 5 ditëve nga dita e shpalljes, ndërsa për personat e tretë në mungesë, shoqëria “Veneto Bank” sh.a., Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Tiranë, ky afat fillon nga dita e njoftimit të vendimit.

U shpall në Tiranë sot, në datën 22 tetor 2015, ora 10:01.

SEKRETARE GJYQËSORE
Megi Anxhela Muhaj

GJYQTARE
Rezarta Mataj

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.